



## Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

### Raport i Misionit të OSBE-së në Kosovë 03/2010 Për monitorimin e Kuvendit të Kosovës 1 maj 2010 – 30 qershor 2010

#### Pikat kyçe

- Kuvendi miraton Ligjin për shërbimin civil, duke përfshirë amendamentet e propozuara nga Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve
- Kuvendi miraton Raportin vjetor të Këshillit të pavarur mbikëqyrës
- Kuvendi miraton Ligjin mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e Deputetëve
- Kuvendi miraton Programin për barazinë gjinore në Kosovë

#### 1. Sfondi

Ky raport i 68-të i monitorimit është hartuar në pajtim me Termat e Referencës për Monitorimin e Kuvendit të Kosovës nga Shtylla e III-të të UNMIK-ut për Ndërtimin e Institucioneve (OSBE), më 26 nëntor 2002, si dhe bazohet në përputhshmërinë me Rregulloren e punës të miratuar në seancën plenare të 29 prillit 2010.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar gjashtë seanca të rregullta plenare, më 13 maj, 27 maj, 4 qershor, 10 qershor, 17 qershor dhe 25 qershor, si dhe shtatë takime të Kryesisë, më 6 maj, 18 maj, 1 qershor, 8 qershor, 15 qershor, 21 qershor si dhe 29 qershor. Gjatë periudhës së raportimit, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar 41 takime të komisioneve dhe tri dëgjime publike.

#### 2. Pasqyrë

**Seanca plenare e 13 majit** u kryesua nga Kryetari i Kuvendit, Z. Jakup Krasniqi (Partia Demokratike e Kosovës - PDK) dhe një anëtar i Kryesisë, Z. Ibrahim Gashi (Aleanca për Kosovën e Re - AKR).

- Në seancën plenare të 13 majit ishin të pranishëm shtatëdhjetë e tre deputetë.<sup>1</sup>
- Pikat kryesore të rendit të ditës për seancën plenare të 13 majit:
  - Pyetje për Qeverinë për përgjigje verbale
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin civil të Kosovës (Projektligji u miratua me 80 vota pro dhe një votë kundër)
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Pagat e shërbyesve civilë (Projektligji u miratua me 79 vota pro dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shpronësimin e pronave të paluajtshme (Projektligji u miratua në parim me 63 vota pro dhe një votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Efikasitetin e energjisë

<sup>1</sup> Ky është numri që u dha nga Kryetari i Kuvendit në fillim të seancës plenare. Megjithatë, kjo shifër nuk i përgjigjet numrit të përgjithshëm të votave për pikat e rendit të ditës si më poshtë, sepse nuk përfshin abstenimet dhe numrin e deputetëve që nuk kanë dhënë votën e tyre fare. Kjo vërejtje vlen edhe për seancat tjera plenare të raportuara në këtë dokument.

- (Projektligji u miratua në parim me 68 vota pro dhe dy kundër)
- Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga Qeveria në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (amendamentet u miratuan me 83 vota pro dhe një votë kundër)
- Debat i mbi gjendjen aktuale të ndërmarrjeve publike qendrore në Kosovë (Z. Driton Tali (i pavarur) dha një deklaratë hyrëse, si sponsorues i debatit<sup>2</sup>; ai u pasua nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe disa deputetë tjerë . Në fund të debatit, Z. Tali dha një deklaratë përmbyllëse.)
- Shqyrtimi i Raportit Vjetor 2009 të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (raporti vjetor u miratua me 45 vota pro dhe 11 vota kundër)
- Shqyrtimi i Raportit Vjetor 2009 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (Raporti vjetor u diskutua në seancë, por votimi i tij u shty për seancën e radhës, për shkak të mungesës së kuorumit. Për më shumë hollësi, shih më poshtë pjesën me titull “Kuorumi”).)
- Shqyrtimi i Programit të Qeverisë për Barazinë Gjinore në Kosovë<sup>3</sup> (Programi u diskutua në seancë, por votimi i tij u shty për seancën e radhës, për shkak të mungesës së kuorumit. Shih më poshtë pjesën me titull “Kuorumi” për më shumë hollësi.)

**Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës më 27 maj** u kryesua nga Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe dy anëtarë të Kryesisë, Z. Sabri Hamiti (Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK) dhe Z. Eqrem Kryeziu (LDK).

- Shtatëdhjetetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 27 majit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 27 majit:
  - Deklaratat e deputetëve
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje verbale
  - Ratifikimi i marrëveshjes mes Qeverisë së Kosovës dhe Asociacionit për Zhvillim Ndërkombëtar<sup>4</sup> (ratifikimi i marrëveshjes u refuzua, me 68 vota pro dhe 15 vota kundër, pasi nuk mori mbështetjen e 2/3 të gjithë Deputetëve .)
  - Votimi i Raportit Vjetor të 2009-ës nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

<sup>2</sup> Z. Driton Tali, mbështetur nga 11 deputetë, ka parashtruar kërkesë për debat për gjendjen aktuale të ndërmarrjeve qendrore publike në Kosovë.

<sup>3</sup> Më 13 maj, Kuvendi diskutoi Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore për periudhën 2008- 2013, propozuar nga Qeveria. Programi përqendrohet në gjashtë fusha specifike: (i) integrimi i grave në ekonomi, (ii) integrimi i grave në tregun e punës dhe mirëqenia e tyre sociale, (iii) gratë në procesin e vendim-marrjes, (iv) kujdesi shëndetësor për gruan dhe qasja në shërbime shëndetësore, (v) edukimi i gruas dhe (vi) përfaqësimi i gruas në kulturë dhe media. Programi mundohet të sigurojë pjesëmarrje të barabartë të meshkujve dhe grave në jetën sociale, ekonomike dhe politike në Kosovë. Komisioni parlamentar për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione publike, si komision përgjegjës, mbështeti Programin dhe rekomandoi që të përfshijë edhe përfaqësimin e gruas në agjencitë e sigurisë dhe themelimin e zyrave të barazisë gjinore në komuna, në pajtim me Ligjin për Barazinë gjinore, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/08. Gjitha grupet parlamentare mbështetën Programin dhe Rekomandimet e Komisionit.

<sup>4</sup> Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar (International Development Association - IDA) është pjesë e Bankës Botërore e cila ndihmon vendet në zhvillim duke ofruar kredi me kamatë të ultë apo pa të si dhe grante për programe të cilat nxisin rritjen ekonomike dhe përmirësojnë kushtet e jetesës së njerëzve. IDA plotëson krahun tjetër huadhënës të Bankës Botërore – Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) – e cila i shërben vendeve me të ardhura të mesme me investime kapitale dhe shërbime këshilluese. Qëllimi i marrëveshjes mes Qeverisë së Kosovës dhe IDA-s është financimi i një projekti për modernizimin e sektorit publik si dhe financimi i një projekti për regjistrimin e pronave të paluajtshme dhe kadastrin. Sipas Marrëveshjes, IDA ofron 5,200,000 Euro për Qeverinë, të përbërë nga një kontribut financiar prej 2,300,000 Euro, si dhe huas deri në 2,900,000 Euro.

- (raporti vjetor u miratua me 47 vota pro dhe 18 vota kundër)
  - Votimi i Programit Qeveritar për Barazinë Gjinore në Kosovë (Programi u miratua me 62 vota pro dhe tetë vota kundër.)
  - Debatimi për “cenimin e integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës nga Serbia” (Debatimi u mbajt me kërkesë të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD). Në fillim të debatit, sponsoruesi i debatit, Z. Lulzim Zeneli (LDD), dha fjalimin hyrës, si dhe u pasua nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe disa deputetë tjerë. Në fund të debatit, u miratua një deklaratë me 58 vota pro dhe asnjë votë kundër<sup>5</sup>.)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimit diplomatik të Kosovës (Projektligji u miratua në parim me 58 vota pro dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i Projektligjit për Rripranim (Projektligji u miratua në parim me 61 vota pro dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Kompanitë Tregtare (Projektligji u miratua në parim me 62 vota pro dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Kosovës (Projektligji u miratua në parim me 63 vota pro dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Projektligji u miratua në parim me 55 vota pro dhe dy vota kundër)
  - Shqyrtimi i raportit vjetor 2009 të Komisionit për Ndhimë Juridike (raporti vjetor u miratua me 65 vota pro dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i raportit vjetor 2009 të Komisionit të Konkurrencës së Kosovës (raporti vjetor u miratua me 55 vota pro dhe pesë vota kundër)
  - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit *ad hoc* në lidhje me emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave (emërimet u miratuan me shumicë të votave pro dhe asnjë votë kundër<sup>6</sup>)
  - Shqyrtimi i propozimeve të grupit parlamentar në lidhje me zëvendësimin e anëtarëve të tyre në komisione<sup>7</sup>
- (Kuvendi miratoi zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve me shumicë votash)

<sup>5</sup> Debatimi u përqendrua në zgjedhjet komunale të organizuara nga Beogradi në komunat veriore të Kosovës, gjë që u konsiderua si shkelje e integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës. Në fund të debatit, Kuvendi miratoi një deklaratë që bën thirrje që Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, të ndalojë organizimin e zgjedhjeve komunale dhe aktiviteteve tjera të Qeverisë së Serbisë në territorin e Kosovës, të ndalojë vizitat e zyrtarëve të qeverisë serbe pa lejen e institucioneve të Kosovës, si dhe të hartojë një plan veprimi për shpërbërjen e strukturave paralele në komunat veriore të Kosovës.

<sup>6</sup> Z. Daut Demaku dhe Znj. Venera Hajrullahu u emëruan si anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media për një mandat dy-vjeçar.

<sup>7</sup> Grupi parlamentar i PDK-së bëri këto zëvendësime në komisione: Rexhep Hoti zëvendësoi Zafir Berishën si anëtar i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim; Arsim Bajrami zëvendësoi Edita Tahirin, si anëtar i Komisionit për Integritet Evropian; Adem Grabovci zëvendësoi Nerxhivane Dautin, si anëtar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Komunikim; Ismail Kurteshi zëvendësoi Memli Krasniqin, si anëtar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte; Abdyl Ymeri zëvendësoi Hajdin Abazin, si anëtar i Komisionit për Administratë Publike, Vetë-Qeverisje Lokale dhe Media; si dhe Basri Musmurati zëvendësoi Zafir Berishën, si anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Grupi parlamentar i LDK-së bëri këto zëvendësime: Fatmir Rexhepi zëvendësoi Ismet Beqirin, si kryetar i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione Publike; Njomza Emini zëvendësoi Bujar Bukoshin, si zëvendës-kryetar e parë e Komisionit për Integritet Evropian.

Grupi parlamentar i AAK-së bëri këtë zëvendësim: Melihate Tërmkollli zëvendësoi Ahmet Isufin, si anëtare e Komisionit për Administratë Publike, Vetë-Qeverisje Lokale dhe Media.

**Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës më 4 qershor** u kryesua nga Kryetari i Kuvendit, Z. Jakup Krasniqi (PDK), si dhe nga një anëtar i Kryesisë, Z. Naim Maloku (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK).

- Në seancën plenare të 4 qershorit ishin të pranishëm shtatëdhjetë deputetë .
- Pikat kryesore të rendit të ditës për seancën plenare të 4 majit:
  - Deklaratat e deputetëve
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje verbale
  - Ratifikimi i marrëveshjes mes Qeverisë së Kosovës dhe Asociacionit për Zhvillim Ndërkombëtar  
(pika u shty për shkak të mungesës së kuorumit.)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Punën  
(Projektligji u miratua në parim me 74 vota pro dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës  
(Projektligji u miratua në parim me 63 vota pro dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis  
(Projektligji u miratua në parim me 62 vota pro dhe gjashtë vota kundër)
  - Shqyrtimi i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve  
(Ligji u miratua me 74 vota pro dhe dy vota kundër)
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hetimet parlamentare  
(Projektligji u miratua me 74 vota pro dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gazetën Zyrtare  
(Projektligji u miratua me 76 vota pro dhe një votë kundër.)

**Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës më 10 qershor** u kryesua nga Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi (PDK) dhe nga një anëtar i Kryesisë, Z. Xhavit Haliti (PDK).

- Në seancën plenare të 10 qershorit ishin të pranishëm gjashtëdhjetë e shtatë deputetë.
- Pikat kryesore të rendit të ditës për seancën plenare të 10 qershorit:
  - Deklaratat e Deputetëve
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje verbale
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kryqin e Kuq  
(Projektligji u miratua me 64 vota pro dhe tri vota kundër)
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Emblemën e Kryqit të Kuq dhe emblemave e distinktivëve tjerë  
(Projektligji u miratua me 28 vota pro dhe gjashtë vota kundër)
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara  
(Projektligji u miratua me 70 vota pro dhe një votë kundër)
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimeve kibernetike  
(Projektligji u miratua me 65 vota pro dhe një votë kundër)
  - Shqyrtimi i raportit financiar për buxhetin e Kosovës për vitin 2009  
(raporti u miratua me 44 vota pro dhe nëntë vota kundër)
  - Shqyrtimi i raportit vjetor të vitit 2009 të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm  
(raporti u miratua me 55 vota pro dhe një votë kundër)

**Seanca Plenare e Kuvendit të Kosovës e mbajtur më 17 Qershor** u kryesua nga Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtar i kryesisë, z. Slobodan Petrović (Partia e Pavarur Liberale - SLS).

- Në seancën plenare të 17 qershorit ishin të pranishëm shtatëdhjetë e katër deputetë.
- Pikat kryesore të rendit të ditës në seancën plenare të 17 qershorit ishin:
  - Deklaratat e deputetëve
  - Pyetjet për përgjigje gojore nga Qeveria
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qasje në dokumente zyrtare (Projektligji u miratua në parim me 56 vota për dhe tetë vota kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e sistemit të sigurimit të depozitave për institucionet financiare (Projektligji u miratua në parim me 61 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i Raportit Vjetor për vitin 2009 të Agjencisë Kosovare të Pronës (Raporti i miratua me 44 vota për dhe 11 vota kundër)
  - Shqyrtimi i Raportit Vjetor për vitin 2009 të Autoritetit të Aviacionit Civil (Raporti i miratua me 66 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2009 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (Raporti u miratua me 45 vota për dhe 11 vota kundër)
  - Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2009 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (KPM) (Raporti u miratua me 53 vota për dhe dy vota kundër)
  - Shqyrtimi i kërkesës për pagesë të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (Kjo pikë u shty për shkak të mungesës së kuorumit.)

**Seanca Plenare e Kuvendit të Kosovës e mbajtur më 25 qershor** u kryesua nga Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtarët e Kryesisë, z. Sabri Hamiti (LDK) dhe z. Xhavit Haliti (PDK).

- Në seancën plenare të 25 qershorit ishin të pranishëm shtatëdhjetepesë deputetë.
- Pikat kryesore të rendit të ditës së seancës plenare të 25 qershorit:
  - Deklaratat e deputetëve
  - Pyetjet për përgjigje gojore nga Qeveria
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ripanim (Projektligji u miratua me 64 vota për dhe dy kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumente të udhëtimit (Projektligji u miratua në parim me 60 vota për dhe gjashtë vota kundër)
  - Votimi për kërkesën për pagesë të anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (Kërkesa u miratua me 34 vota për dhe 25 vota kundër)
  - Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e natyrës (Kërkesa u miratua me 52 vota për dhe shtatë vota kundër)
  - Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Administratë Publike, Vetëqeverisje Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Procedurës Administrative (Kërkesa u miratua me 58 vota për dhe tri vota kundër)

- Shqyrtim i rekomandimit të propozuar nga Gjykata Supreme lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Ankesave për Media (BAM)<sup>8</sup>  
(Rekomandimi i refuzua me 66 vota për dhe asnjë votë kundër)

### 3. Praktikrat parlamentare dhe procedurat e seancave plenare

#### Proceset legjislativ

- Gjatë periudhës shqyrtuese, Kuvendi miratoi nëntë ligjet në vijim:

Emri	Komisioni Funkcional	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi i dytë	Afati kohor
Ligji për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjes së tipografive të qarqeve të integruara	Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Komunikime	24 korrik 2009	10 qershor	10 muaj
Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë	Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Komunikime	24 korrik 2009	10 qershor 2010	10 muaj
Ligji për pagat e shërbyesve civil <sup>9</sup>	Komisioni për Administratë Publike, Vetëqeverisje Lokale dhe Media	29 tetor 2009	13 maj 2010	6 muaj
Ligji për shërbimin civil e	Komisioni për Administratë Publike, Vetëqeverisje Lokale dhe Media	29 tetor 2009	13 maj 2010	6 muaj
Ligji për hetimet parlamentare	Komisioni për Legjislacion dhe Çështje Gjyqësore	19 nëntor 2009	4 qershor 2010	6 muaj
Ligji për gazetën zyrtare	Komisioni për Legjislacion dhe Çështje Gjyqësore	11 shkurt 2010	4 qershor 2010	4 muaj
Ligji për emblemën e Kryqit të Kuq dhe emblemat dhe shenjat tjera dalluese	Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	28 janar 2010	10 qershor 2010	4 muaj
Ligji për Kryqin e Kuq	Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	28 janar 2010	10 qershor 2010	4 muaj
Ligji për ripranim	Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri	27 maj 2010	25 qershor 2010	1 muaj

*Koment: Të gjitha Projektligjet e referuara më lart, përveç atij për ripranim, janë miratuar nga Kuvendi pas kalimit të aftit përfundimtar që kërkohet nga neni 57.6 i*

<sup>8</sup> BAM është organ që shqyrton ankesat e palëve që janë drejtpërsëdrejti të prekura nga vendimet e Komisionit të Pavarur për Media (KPM). Sipas nenit 22.4 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/34, dy anëtarët vendorë të BAM-së duhet të propozohen nga Gjykata Supreme dhe të emërohen nga Kuvendi pas shpalljes publike për propozime nga Këshilli i KPM-së. Sipas Ligjit për KPM-në, Gjykata Supreme ka nominuar z. Avdi Dinajin dhe znj. Fllanza Kadiun. Mirëpo, duke qenë se motra e znj. Kadiu aktualisht mbanë post të lartë menaxherial në Radio Televizionin e Kosovës, Kryeshefja Ekzekutive ka kërkuar nga dy Komisione të Kuvendit që të japin mendimin e tyre nëse emërimi do të përbënte situatë të konfliktit të interesit. Komisioni për Legjislacion dhe Çështje Ligjore dhe Komisioni për Administratë Publike, Vetëqeverisje lokale dhe Media i kishin rekomanduar Kuvendit që të mos e miratojë propozimin e znj. Fllanza Kadiu për Bordin e Ankesave për Mediave (BAM) për të shmangur situatën e konfliktit të interesit. Në bazë të kësaj, Kuvendi ka refuzuar propozimin.

<sup>9</sup> Më 26 janar 2010, me kërkesë të Komisionit për Administratë Publike, Vetëqeverisje Lokale dhe Media, Kryesia e Kuvendit zgjati afatin e fundit për shqyrtim të projektligjit për pagat e shërbyesve civilë dhe projektligjit për shërbimin civil për 15 ditë, mirëpo Komisioni e kishte tejkaluar afatin e fundit për tre muaj.

*Rregullores së re të Punës, e cila parasheh që “komisioni funksional i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për Projektligjin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë.” Shumë raporte të mëparshme të monitorimit kanë theksuar gjithashtu që komisionet po kanë vazhdimisht vështirësi në shqyrtimin dhe raportimin e rekomandimeve të tyre për Projektligjet në përputhje me afatin kohor të paraparë në Nenin 57.6. Më 24 mars, pas miratimit nga kryesia, kuvendi ka shpallur 13 vende të lira pune për ekspertë për mbështetjen e punës së komisioneve. Prandaj rekomandohet që komisionet të shfrytëzojnë ekspertizën, e cila shpejtë do të jetë në dispozicion për to, dhe të bëjnë përpjekje që të shqyrtojnë Projektligjet brenda afatit të kërkuar kohor, me qëllim të shtimit të efikasitetit të procesit legjislativ.*

- Në takimin e saj të 29 qershorit, Kryesia ka pranuar një mocion të parashtruar nga z. Emrush Xhemajli (Partia Socialiste-PS), që është mbështetur nga 66 deputetë tjerë, në të cilin ai kishte propozuar që Kuvendi të udhëzojë Qeverinë që ta ndryshojë dhe plotësojë Ligjin për statusin dhe të drejtat e familjeve të heronjve, invalidëve dhe veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe të Familjeve të viktimave civile të luftës<sup>10</sup>. Kryesia vendosi që të kërkojë nga qeveria që ta përshpejtojë procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit në fjalë dhe ta dorëzojë atë së shpejti në Kuvend, sepse qeveria veçse kishte përfshirë Projektligjin e ri për statusin e familjeve të martirëve të UÇK-së invalidëve dhe veteranëve të viktimave civile në agjendën e saj legjislative për vitin 2010.

*Koment: Vendimi i kryesisë ishte në përputhje me nenin 53.2 të Rregullores së re të Punës e cila parasheh që “Projektligji i paraqitur nga kryetari, deputetët, komisionet parlamentare, grupet parlamentare, i dërgohet Qeverisë, përmes Kryesisë së Kuvendit, për të marrë mendimin e saj.*

- Më 15 qershor, Komisioni për Administratë Publike, Vetëqeverisje Lokale dhe Media paraqiti pranë Zyrës së Pranimi Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe transmetim, të hartuar nga vetë ky Komision. Në takimin e tij të 21 qershorit, kryesia ka pranuar Projektligjin në fjalë dhe ka vendosur që të kërkojë nga qeveria që ta paraqes mendimin e saj, përfshirë edhe një deklaratë për implikimet buxhetore të Projektligjit, brenda një afati njëmuajor.

*Koment: Vendimi i kryesisë nuk ka qenë në përputhje me nenin 53.2 të Rregullores së re të Punës, e cila parasheh që Projektligji i propozuar nga komisioni parlamentar duhet t’iu dërgohet qeverisë për ta marrë mendimin e saj. Përveç kësaj, neni 53.3 thekson që qeveria duhet ta paraqes mendimin e saj jo më vonë se një muaj nga dita e pranimi të Projektligjit, dhe që pas këtij afati, Projektligji duhet t’i procedohet Kuvendit për shqyrtim.*

### Shpërndarja e Projektligjeve

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme është shpërndarë më 20 prill. Pra, Projektligji është shpërndarë 15 ditë pune më herët para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të 13 majit. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës, Projektligji për Ripranim dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kompanitë Tregtare janë shpërndarë më 4 maj; Projektligji për Bankën Qendrore të Kosovës është shpërndarë më 6 maj dhe Projektligji për Mbrotjtjen e Natyrës është shpërndarë më 7 maj. Pra Projektligjet e lartcekura janë

<sup>10</sup> Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 shkurt 2006, megjithëse nuk janë publikuar as Rregullorja e UNMIK-ut 2006/29 që e ka shpallur ligjin, dhe as vetë ligji.

shpërndarë 15, përkatësisht 13 dhe 12 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 27 majit.

Projektligji për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë të Kosovës është shpërndarë më 13 maj, Projektligji për Punën është shpërndarë më 14 maj dhe Projektligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis është shpërndarë më 19 maj. Pra Projektligjet e lartcekura janë shpërndarë 15, përkatësisht 14 dhe 11 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 4 qershorit.

Projektligji për Qasjen në Dokumentet Zyrtare dhe Projektligji për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë janë shpërndarë më 1 qershor. Pra Projektligjet e lartcekura janë shpërndarë 11 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 17 qershorit.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit është shpërndarë më 8 qershor. Pra Projektligji në fjalë është shpërndarë 12 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të 25 qershorit.

*Koment: Neni 56.1 i Rregullores së re të Punës së Kuvendit përcakton që “shqyrtimi i parë i një Projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë pune dhe as më vonë se katër javë pune, nga dita e shpërndarjes së tij.” Pra të gjitha Projektligjet e lartcekura janë shqyrtuar në pajtim me nenin 56.1, që pasqyron një përmirësim në krahasim me periudhën e mëhershme të raportimit.*

#### Kuvendi miratoi raportet vjetore të nëntë institucioneve të pavarura, përfshirë atë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (KPM)

- Gjatë muajve maj dhe qershor, Kuvendi diskutoi dhe miratoi raportet vjetore për vitin 2009 të nëntë institucioneve dhe agjencive të pavarura, përfshirë ato të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Komisionit për Ndihmë Juridike, Komisionit Kosovar të Konkurrencës, Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Agjencisë Kosovare të Pronës, Autoritetit të Aviacionit Civil, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (KPM-së). Në seancën plenare të 17 qershorit, gjatë diskutimit të raportit vjetor të KPM-së, deputetët shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me dështimin e institucioneve publike për të zbatuar vendimet e KPM-së, siç edhe theksohet në raportin e KPM-së. Në vitin 2009, shërbyesit civil kanë parashtruar 288 ankesa në KPM: 163 ankesa janë parashtruar kundër komunave, 81 kundër ministrive dhe 44 kundër agjencive dhe institucioneve të pavarura. Sipas raportit, përkundër faktit që vendimet e KPM-së ishin të formës së prerë, autoritetet punëdhënëse nuk zbatuan 76 vendime dhe ky fakt përbënte një shqetësim për deputetët dhe KPM.

*Koment: Duket se ka një trend pozitiv ndër institucionet e pavarura në paraqitjen e raporteve të tyre vjetore me kohë dhe në Kuvend gjatë diskutimit dhe shqyrtimit të hollësishëm të tyre dhe ofrimit të rekomandimeve. Është vërejtur që Kuvendi po merr një qasje proaktive për ndërlidhje me institucionet dhe agjencitë e pavarura në ushtrimin e plotë të rolit mbikëqyrës të tij. Sipas raportit të KPM-së, sfida kryesore operative për këtë institucion mbetet mungesa e gatishmërisë nga ana e autoriteteve ekzekutive për zbatimin e vendimeve të KPM-së. Prandaj, Misioni i OSBE-së në Kosovë ofron mbështetje për KPM-në duke fuqizuar kapacitetet e brendshme për të siguruar zbatimin e suksesshëm të mandatit të saj.*

#### Kuorumi

- Gjatë seancës plenare të 13 majit, përkatësisht në fund të debatit për raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe për Programin mbi Barazinë Gjinore në



Kosovë, kryesuesi i seancës deklaroi që 59 deputetë ishin të pranishëm në sallë por se ky numër nuk ishte i mjaftueshëm për të votuar për këto dy dokumente. Pra, për shkak të mungesës së kuorumit, kryesuesi shtyu votimin e raportit të AKP-së dhe të Programit për Barazinë Gjinore për seancën e ardhshme plenare.

*Koment: Vendimi i Kryesuesit për të shtyrë votimin për raportin e AKP-së dhe për Programin mbi Barazinë Gjinore ishte në pajtim me nenin 51.3 që përcakton se “Vendimet e mbledhjeve të Kuvendit janë të vlefshme, në qoftë se në kohën kur ato janë marrë, në sallë kanë qenë më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit.” Raportet e mëhershme të monitorimit kanë theksuar situata të ngjashme, ku pikat rendit të ditës janë shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit, duke shkaktuar kështu vështirësi në menaxhimin e seancave plenare. Rekomandohet që Kryesia e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare të adresojnë çështjen e mungesës së deputetëve në seancat plenare, për të siguruar pjesëmarrje më të mirë të deputetëve dhe për të shmangur situatat e lartpërmendura.*

#### Kuvendi zbatoi dispozitat e reja për pyetjet parlamentare

- Gjatë kohës për pyetje parlamentare në seancën e 13 majit, qeveria ishte përgjigjur në 13 nga 17 pyetjet e parashtruara dhe katër pyetje ishin shtyrë për seancën e ardhshme. Më 27 maj, qeveria ishte përgjigjur në 9 nga 13 pyetjet e parashtruara dhe katër pyetje ishin shtyrë për seancën e ardhshme. Në seancën plenare të 4 majit, qeveria ishte përgjigjur në tetë nga 18 pyetjet e parashtruara dhe dhjetë pyetje ishin shtyrë për seancën plenare. Në seancën plenare të 10 qershorit, 12 pyetje ishin parashtruar nga deputetët ndërsa ishin dhënë vetëm katër përgjigje dhe në nëntë pyetje nuk kishte përgjigje për shkak të mungesës së ministrave dhe anëtarëve përkatës që kishin parashtruar pyetjet. Pyetjet tjera parlamentare ishin shtyrë për seancën e ardhshme plenare. Në seancën plenare të 17 majit, 16 pyetje ishin parashtruar nga deputetët ndërsa 14 përgjigje ishin dhënë dhe dy ishin shtyrë për seancën e ardhshme. Në seancën plenare të 25 qershorit, qeveria ishte përgjigjur në tetë nga nëntë pyetjet e parashtruara dhe një pyetje ishte shtyrë për seancën e ardhshme. Kryetari i Kuvendit deklaroi që pyetjet, për të cilat nuk ishte dhënë ndonjë përgjigje në dy seancat plenare, do të botohen në buletin e Kuvendit.

*Koment: Koha për pyetje parlamentare gjatë periudhës së raportimit është zbatuar në pajtim me Nenin 45 të Rregullores së re të Punës “Pyetjet parlamentare për Qeverinë për përgjigje me gojë”, që përcakton se rendi i ditës për secilën seancë parasheh 60 minuta për pyetje parlamentare të deputetëve për qeverinë, dy minuta për pyetje, tri minuta për përgjigjen e ministrit, një minutë për pyetje plotësuese nga deputetët dhe dy minuta për përgjigjen në pyetjen plotësuese, dhe që një deputet mund të parashtrrojë më së shumti dy pyetje parlamentare gjatë një seance plenare.*

*Shumë raporte të mëhershme të monitorimit kishin theksuar që të gjitha pyetjet parlamentare nuk mund të procedohen brenda 50 minutave, siç ishte përcaktuar me rregulloren e vjetër të Kuvendit, për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara nga deputetët. Për këtë arsye, Komisioni për Rregulloren e Punës përfshiu dispozitat e reja që përcaktojnë se koha për pyetje parlamentare zgjat deri në 60 minuta dhe që një deputet gëzon të drejtën e parashtrimit të dy pyetje gjatë një seance plenare. Dispozitat e reja kanë për qëllim shfrytëzimin më efikas të kohës për pyetje parlamentare, duke iu siguruar deputetëve që parashtrorin pyetje një mundësi më të mirë për të marrë përgjigje me kohë. Megjithatë, mungesa e qeverisë për tu përgjigjur me kohë po i shkakton vështirësi Kuvendit në menaxhimin e duhur të kohës për pyetje parlamentare. Prandaj*

*Kuvendi duhet të përpiqet më shumë dhe duhet të përdor autoritetin e tij për të siguruar llogaridhënien e qeverisë, që është një standard kyç i demokracisë parlamentare.*

#### **4. Qasja e barabartë dhe pjesëmarrja e komuniteteve**

Kuvendi miratoi Projektligjin për Shërbimin Civil, përfshirë amendamentin për përfaqësimin e pjesëtarëve të komuniteteve joshqiptare

- Më 14 maj, Kuvendi i Kosovës miratoi Projektligjin për Shërbimin Civil përfshirë edhe një ndryshim i cili ishte propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, që përcakton më saktë përfaqësimin e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil. Nëpërmjet këtij ndryshimi, Komisioni propozoi që së paku 10 për qind e pozitive në shërbimin civil të institucioneve qendrore duhet të ndahen për pjesëtarët e komuniteteve joshqiptare. Përveç kësaj, ndryshimi i propozuar përcakton që në nivel komunal komunitetet në pozitë të pakicës duhet të përfaqësohen në proporcion me përqindjen e komuniteteve jo-shumicë në komunën e caktuar.

*Koment: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil ishte caktuar për seancën plenare të Kuvendit më 29 prill. Megjithatë, shqyrtimi i dytë ishte shtyrë për seancën plenare të 13 majit për shkak se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi kishte kundërshtuar ndryshimet e propozuara nga Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media. Si pasojë e këtyre mospajtimeve mes këtyre dy komisioneve, Kuvendi vendosi të shtyjë debatin e caktuar për seancën plenare të 13 majit, ashtu që komisionet të zgjidhnin mospajtimet e tyre. Më vonë, komisionet u takuan dhe shqyrtuan prapë ndryshimet e propozuara nga komisioni i përhershëm dhe zgjidhën mospajtimet e tyre. Fillimisht, komisioni i përhershëm kishte propozuar 203 ndryshime por pas takimit me Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi u pajtua të propozojë vetëm 67 ndryshime, që të gjitha të miratuara nga Kuvendi.*

#### **5. Qasja**

- Gjatë periudhës së raportimit, Misioni i OSBE-së në Kosovë vazhdoi të ketë qasje në seancat plenare, mbledhjet e kryesisë, mbledhjet e komisioneve dhe dëgjimet publike. Gjithashtu, Misioni i OSBE-së në Kosovë pranoi kopjet e dokumenteve të shqyrtuara nga Kuvendi dhe transkriptet e seancave plenare.

#### **6. Transparenca**

- Gjatë kohës së raportimit Kuvendi nuk ka publikuar procesverbalin e votimit elektronik të seancave plenare.

*Koment: Sipas nenit 51.7 të Rregullores së re të Punës, procesverbali i votimit elektronik i deputetëve publikohet brenda tri ditë pune pas mbledhjes plenare. Megjithatë, Kuvendi nuk publikoi procesverbalin e votimit elektronik të ndonjë seance plenare gjatë periudhës së raportimit, gjë që ishte në kundërshtim me nenin 51.7. Rekomandohet fuqimisht që Kuvendi të publikojë procesverbalin e votimit elektronik, siç edhe përcaktohet me Rregulloren e re të Punës, për të shtuar transparencën e Kuvendit dhe posaçërisht llogaridhënien e deputetëve kundrejt zgjedhësve të tyre.*

- Radio Televizioni i Kosovës siguroi mbulim të drejtpërdrejtë të seancave plenare që janë monitoruar. Qytetarët dhe monitoruesit institucional kishin qasje në seancat plenare. Kuvendi ka një ueb faqe ([www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org), [www.skupstinakosova.org](http://www.skupstinakosova.org), [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)) që përmban hollësitë biografike të deputetëve, informata për

strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbalet dhe transkriptet e seancave të Kuvendit dhe mbledhjeve të Komisioneve, kopjet e ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi së bashku me informata tjera.

FUND.